



Pranuar / Dorezuar Primjen/Prodato Received/Delivry	16.10.2020	viti god year	0
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtori + Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMŠHOK	2143/2020		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.258/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 1687/2020 të datës 03.09.2020 të parashtruar nga ankuesi [REDACTED] me adresë banimi rr"Bill Klinton" Lagja Dardania , Blloku 5 E1 nr.13, Prishtinë , kundër organit të punësimit- Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.10.2020, mori këtë .

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.258/2020 e datës 03/09/2020 e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]

II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr.11/2020 i datës 10/07/2020 i protokolluar me Nr. Prot:326/20 datë 04/08/2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED], i caktuar në pozitën e Inspektorit pranë Inspektoriatit të ARC-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas vendimit të datës 14.05.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së, me datën 17.06.2019 ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm që ti realizohet pagesa e rrezikshmërisë në vlerë prej njëqind e shtatë (107) euro nga data e caktimit në pozitën e Inspektorit pranë Inspektoriatit të ARC-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ankuesi pasi nuk ka marrë përgjigje në kërkesën e datës 17.06.2019 me datën 02.07.2020 ka parashtruar ankesën me nr.protokollit 271/20 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme për pagesën e rrezikshmërisë në shumë prej njëqind e shtatë (107) euro.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me vendimin e datës 10.07.2020 me nr. 11/2020 ka hedhë poshtë si të jashtëafatshme ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 10.07.2020 me nr. 11/2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 03.09.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1687/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2020, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ministria e Punëve të Brendshme me datë 07.10.2020 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1687/2020 të datës 03.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.11/2020 i datës 10.07.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 14.05.2019 me numër protokollit 2687 i Drejtorit të Përgjithshëm i ARC; Kërkesë për aprovimin e rrezikshmërisë në punë e datës 17.06.2019; Kërkesë për aprovimin e rrezikshmërisë në punë e datës 14.05.2020; E-mail i datës 19.05.2020; E-mail i datës 20.05.2020; E-mail i datës 21.05.2020; Kërkesë për aprovimin e rrezikshmërisë në punë e datës 03.06.2020; Ankesa e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me nr.271/20 e datës 02.07.2020 dhe Përgjigje në ankesë e datës 07.10.2020 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit [REDACTED], është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi, ankesën me numër protokollit 271/20 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme për pagesën e rrezikshmërisë në shumë prej njëqind e shtatë (107) euro e ka parashtruar në datë 02.07.2020, ndërsa Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme ankesën e tij e ka hedhë poshtë si të jashtë afatshme duke konstatuar që e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe jashtë afatit të paraparë me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave ka përcaktuar se **“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës”**, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 11/2020 të datës 10.07.2020 i protokolluar me Nr. Prot:326/20 më datë 04/08/2020, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit ██████████
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.258/2020**

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit



Sabile AVDYLI
Procesmbajtëse

Gahile Avdyli

